



Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	25-08-2023	3 viti god year
Organ /Njesia Org./Umit	5822	2023
Tit. Prot Tit. Prot No		
Shtojca Prilog Appendix		
Sasia Kolicina Quantity		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.952/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.952/2023 të datës 12.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rr. [redacted] Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore-Largim nga Shërbimi Civil", kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 24.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.952/2023 e datës 12.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. MBETET në fuqi Vendimi i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me numër KD.nr.030/23 i datës 13.06.2023.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në vendin e punës "Asistent i Financave" në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 05.03.2013, ka parashtruar ankesë me datë 12.07.2023, nën shenjën 5157/2023 është regjistruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës me numër KD.nr.030/23 i datës 13.06.2023;

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 24.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 5157/2023 të datës 12.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga Sh.H. për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 12.07.2023; Vendim i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me numër KD.nr.030/23 i datës 13.06.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 21.07.2023; E-mail nga C.Z. për A.K. i datës 21.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 24.07.2023; E-mail nga A.K. për C.Z. i datës 21.07.2023; Shkresat e lëndës e datës 21.07.2023; Përgjigje në ankesë; Fletëkthesë e datës 14.06.2023; Kërkesë me numër protokoli 806 e datës 08.06.2023; Vendim i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me numër KD.nr.030/2023 i datës 20.05.2023; Leje nga Gjykata Themelore Mitrovicë DKR me numër PPr.nr.79/23 i datës 07.06.2023; Aktvendim mbi fillimin e hetimeve Gjykata Themelore Mitrovicë DKR me numër PP.I.nr.87/23 i datës 15.05.2023; Procesverbal për marrjen e deklaratës së të pandehurit me numër PP.I.nr.87/2023 i datës 06.06.2023; Ftesë për intervistë e datës 06.06.2023; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore me referencë D-24/23 e datës 19.05.2023; Fletëkthesë e datës 25.05.2023; Ftesë për intervistë e datës 09.06.2023; Akt Emërim i Sh.H. i datës 05.03.2013; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 14.05.2007; Vendim me numër protokoli 370 i datës 27.03.2023; Procesverbal i datës 12.06.2023; Procesverbal i datës 09.06.2023; Procesverbal i datës 09.06.2023; Procesverbal i datës 09.06.2023; Kallëzimi Penal nga Policia i datës 19.05.2023; Tabela e përmbajtjes së rastit Nr.:R-2023-XI-HK-HEKE-MIJ-30 (2023-KE-144); Kallëzimi Penal nga Policia i datës 19.05.2023; Raporti fillestar i incidentit nr. i rastit R-2023-XI-HK-HEKE-MIJ-30; Formulari i pranimit dorëzimit i datës 12.05.2023; Informacioni nga institucioni datës 27.04.2023; Raporti informues plotësues nga tereni; Të dhënat e zyrtarit Sh.H.; Të dhënat e të burgosurit J.T. i datës 11.05.2023; E-mail i datës 11.05.2023; Kërkesë për "Dhënia dhe marrja e simuluar e ryshfetit" e datës 15.05.2023; Raport Informues i datës 17.05.2023; Urdhëresë për masa të veçanta hetimore Gjykata Themelore Mitrovicë DKR me numër UGJK.nr.10/23 i datës 17.05.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, fillimisht ka gjetur se ankesa është në kuadër të afatit ligjor, ka vërtetuar kompetencën lëndore dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji ka trajtuar pretendimet e ankuesit me kujdes, ankuesi pretendon se gjatë periudhës së pezullimit të përkohshëm nuk mund të ndërpritet marrëdhënia e punës nga ana e institucionet gjegjësisht Shërbimit Korrektues, Kolegji lidhur me këtë pretendim konstaton se Shërbimi Korrektues më datë: 20.05.2023 me Vendimin nr.030/2023 kishte pezulluar nga puna ankuesin _____ Asistent i Financave në Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë duke u bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 55 paragrafi 1 i cili përcakton se " 1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil", pezullimi në këtë rast është bërë duke u mbështetur në paragrafin 1 të nenit të lartshënuar do të thotë sipas detyrës zyrtare, gjithashtu ky pezullim është i ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 1.1 ku përcaktohet se " 1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji". Prandaj nisur nga këto rrethana ligjore dhe gjendja faktike, Kolegji ka

konstatuar se pretendimi i tillë nga ana e palës ankuese është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura.

Kolegji sipas shkresave të lëndës të parashtruara nga palët (në shkresa gjenden edhe lënda e Gjykatës dhe Policisë) ka konstatuar se ankuesi *istent i Financave në QP-Mitrovice* pas marrëveshjes paraprake me të burgosurin J.T i cili gjendet në vuajtje të dënimit në QP-Mitrovicë Veriore ka kërkuar shumë prej 2500€ me qëllim që të burgosurit J.T t'i mundësoj lirim me kusht, ndërsa sipas shkresave të lëndës ankuesi me datë 19.05.2023 sipas marrëveshjes kishte marrë nga një familjar i të burgosurit J.T shumë prej 1300€ në pikën e karburantit Shell-Petroll në hyrje të Prishtinës, ku në po të njëjtën ditë ankuesi është arrestuar nga Policia e Republikës së Kosovës në Lagjen "Dragodan" në Prishtinë nën dyshimin e marrjes së ryshfetit. Ankuesi është mbajtur për 48h në arrest në qendrën e paraburgimit dhe me të dalur para Gjyqtarit të Procedurës Paraprake i njëjti ka pranuar në tërësi fajësinë dhe Gjykata ka nxjerr aktvendim PPr.nr.79/2023 duke caktuar arrest shtëpiak ndaj ankuesit. Veprimet e lartpërkruara nga ana ankuesit, vetë pala ankuese i konfirmon në seancën e komisionit disiplinor, duke pretenduar se ka biseduar me të burgosurin J.T dhe paratë e pranuar të përshkruara si më lartë ka pasur t'i dërgohen një avokati, i cili do t'i ndihmonte të burgosurit J.T që të lirohet me kusht. Kolegji duke u bazuar në përshkrimin e punës së ankuesit dhe dispozitat ligjore në fuqi këtij pohimi të ankuesit në seancën e Komisionit disiplinor nuk mund të ia falë besimin si të mirëqenë.

Përshkrimin e gjendjes faktike të lartshënuar, përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese në procesverbalin e datës 06.06.2023 për marrjen në pyetje të pandehurit (ankuesit para KPMSHCK-së) deklaroi se citoj " sot më datë 06.06.2023 kam deponuar në prokurori kërkesën për takim paraprak për fillimin e negociimit për pranimin e fajësisë" ndërsa i pandehuri (ankuesi) deklaroi se citoj " pranon këtë fillim të negociimit për pranimin e fajësisë". Prandaj nga deklaratimet e të pandehurit para Prokurorit të shtetit konstatohet pa asnjë dyshim se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës si i punësuar në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji ndërlidhur me gjendjen faktike të lartshënuar, konstaton se ankuesi ka bërë shkelje të nenit 25 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "*Detyrimi i respektimit të ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut 1. Zyrтари publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrтари publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrтари publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike*".

Gjithashtu Kolegji konstaton se në veprimet e ankuesit janë konsumuar të gjitha elementet e Nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "*Përgjegjësia disiplinore 1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*

Gjithashtu Kolegji ka konstatuar se iniciuesi i procedurës disiplinore dhe Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues/Ministria e Drejtësisë me të drejtë kanë konstatuar se veprimet e ankuesit janë shkelje të rënda të detyrave të punës ashtu siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "*përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës*", sepse sipas shkresave të lëndës ankuesi është përfshirë në marrjen e ryshfetit pikërisht duke tentuar të krijoj favore për të burgosurin J.T dhe vetit dobi pasurore në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara.

Kolegji gjithashtu ju referua nenit 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se “ Masat disiplinore 1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil si dhe nenit 48 paragrafi 3 ku përcaktohet se “Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”, prandaj ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues ka zbatuar drejtë të drejtën materiale dhe procedurën e paraparë në këto raste.

Kolegji pas trajtimit të gjitha provave veç e veç dhe në unitetin e tyre, duke marrë për bazë si rrethanë faktike se pala ankuese në këtë rast me vetëdije dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm dhe duke dëmtuar në tërësi reputacionin e Shërbimit Korrektues të Kosovës/Ministritsë së Drejtësisë, ka ardhur në përfundim se masa “largim nga shërbimi civil” i ankuesit është i drejtë dhe në proporcion me veprimet e tij, prandaj Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda.A.nr.952/2023

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

